



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.132/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.01.2025, mori këtë:

#### **VE N D I M**

**Refuzohen** të pabazuara ankesa Anr.132/2025 e datës 22.01.2025 dhe ankesa Anr.133/2025, e datës 22.01.2025, të parashtruara nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### **A r s y e t i m**

Me datën 22.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, në të cilën pretendohet se se kandidatët për deputetë nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës - PDK, Fetah Paçarizi, Kujtim Gashi dhe të tjerë, më 21 janar 2025 kanë vizituar KB "BASHKIMI" në Prizren me qëllim të përfitimit të votave, siç mund të vërehet edhe në postimin e Kryetarit të Komunës së Prizrenit z. Shaqir Totaj i cili është poashtu nga radhët e këtij subjekti, si dhe në provën bashkëngjitur. Me këtë veprim, janë shkelur dispozitat nga neni 36 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Rrjedhimisht, kandidati në fjalë dhe subjekti politik PDK kanë cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkohet që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

Më datë 23.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 20.01.2025 në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 23.01.2025, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), se me asnjë veprim të ankimuar me këtë ankesë, nuk është përdorur as ndonjë institucion apo organ publik, as ambient i zyrës apo ndonjë pasuri të saj dhe gjithashtu nuk janë shfrytëzuar nëpunësit publik për të përfituar dhe për të zhvilluar fushatë subjekti politik, pasi që në rrethanat e rastit konkret, Klubi Basketbollistik "KB Bashkimi" është klub i cili zotëron kryetarin e saj z. Rini Shpendi, drejtorin Artan Kurti dhe si e tillë është e regjistruar si Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuara që rrjedhimisht e njëjta në asnjë mënyrë nuk përbën institucion shtetëror të kontrolluar nga autoritetet qendrore apo locale. Për më tepër edhe lojtarët e këtij klubi basketbollistik nuk janë nëpunës publik, siç pretendohet me ankesë. Andaj kanë propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.132/2025 të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje; dhe të konstatohet se veprimet e ankimuar, nuk përbëjnë shkelje nga neni 34, par. 1, nënpar. 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Fillimisht Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.132/2025 dhe Anr.133/2025, të paraqitura me datë 23.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.132/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se :

#### **-Ankesat janë të pa bazuara**

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga fotografitë dhe nga video incizimi të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesave, nuk mund të vërtetohet se nga ana e Subjektit Politik PDK, është bërë shkelje e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *"personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje"*.

Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet se është realizuar një vizitë, në Klubi Basketbollistik "KB Bashkimi" dhe në Klubin Futbollistik "KF Liria" në të cilin kanë qenë prezent, disa kandidat për deputet të Partisë Demokratike të Kosovës, mirëpo nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës nuk është i argumentuar në asnjë moment në mënyrë të

qartë dhe bindëse se në këtë vizitë është bërë shkelja e dispozitave ligjore në fuqi nga ana e Subjektit Politik PDK apo të kandidatëve të saj, ashtu siç pretendohet nga pala ankuese, pasi që nga të gjitha fotografitë e dorëzuara si provë, përveç që nuk mund të vërehet asnjë shenjë - simbole apo material zgjedhor i subjektit në fjalë, poashtu është vërtetuar se këto klube sportive janë të regjistruara si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara, e të cilat nuk përbëjnë shkelje nga dispozitat e nenit 36 t; LZP, të cilat dispozita i referohen veprimeve ndaluese sa i përket hapësirave publike, shfrytëzimit të nëpunësve publik duke përdorur pozitën publike për të zhvilluar fushatë për subjektin politik si dhe veprimeve të përdorimit të burimeve ose resurseve të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.132/2025 më datën 24.01.2025

Kryesues i Panelit  
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.